

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË "Buoninfante" Sh.p.k.**

Sot, me datë 05 / 12 / 2023,

**Z. Florian Quku**, shtetas shqiptar, i biri i Agronit, lindur më 19.07.1985, në Shkodër, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 036171091 dhe nr. personal I50719060K, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Buoninfante" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Themelohet një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "Buoninfante" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja Skenderbej, Zona industriale jug, Godina 44, Zona kadastrale 8523, nr. pasurie 33/76, Elbasan.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

1. Prodhimin, për llogari të saj ashtu edhe për llogari të palëve të treta, qoftë edhe vetëm për disa faza të punimit, të: dyshekëve, të klasifikuar gjithashtu si pajisje mjekësore, jastëkëve dhe të ngjashëm me ta, bazamenteve ortopedike, krevatëve dhe bazamenteve të krevatëve, kolltukëve dhe divanëve; tapiceri për dhoma ndenjeje, divane dhe kolltuqe me poliuretan të zgjeruar, fiocco, pupla dhe fibra të tjera poliesteri, mobilim në përgjithësi, aksesori mobilimi, aksesori krevatesh, batanije dhe çarçafë;
2. Tregtimin për vete dhe/ose për përfaqësimin me shumicë dhe pakicë të produkteve të specifikuara më sipër, si dhe të gjithë artikujve që mund të kombinohen në fazën e tregtimit të produkteve të tyre;
3. Përpunimin e poliuretanit të zgjeruar për llogari të vetë si dhe për llogari të palëve të treta;
4. Promovimin, organizimin dhe menaxhimin e shitjeve direkte të produkteve të sipërpërmendura dhe gjithashtu tregtimin elektronik, nëpërmjet internetit dhe korrespondencës;
5. Kërkimin dhe zhvillimin me qëllim të krijimit të materialeve të reja dhe proceseve të reja për përmirësimin dhe inovacionin teknologjik të përpunimit.

6. Shoqëria, përveç kësaj, mund të lidhë kontrata licence të markave, për prodhimin dhe tregëtimin e produkteve të veta dhe nga ana tjetër, mund të japë me licencë të drejtën e përdorimit të markave të veta tek të tretët.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i ortakut të vetëm themelues në vlerën 100.000 Lekë dhe është i përbërë nga 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Florian Quku**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicë të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- **Z. Florian Quku**, shtetas shqiptar, lindur më 19.07.1985, në Shkodër, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 029236196, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, caktohet Administrator i shoqërisë.
- Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është 1 (një) vit, me të drejtë ri-emërimi.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Florian Quku**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**FLORIAN QUKU**

*Florian Quku*  
